



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

VENDIM

Nr. 47, datë 26 . 03 . 2026

**PËR NGJYRËN E AUTOMJETEVE TË SHËRBIMIT TAKSI
NË BASHKINË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë të Kontrollit të Territorit “Për ngjyrën e automjeteve të shërbimit taksi në Bashkinë Korçë”, bazuar në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, neni 3 dhe neni 35; ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 54; udhëzimin nr. 1649, datë 16.08.1999, “Mbi plotësimin e disa kushteve të veçanta në transportin rrugor të udhëtarëve”, i ndryshuar, kapitulli IV; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”;

VENDOSI :

1. Autoveturat në transportin e udhëtarëve me taksi të Bashkisë Korçë do të jenë ngjyrë gri.
2. Autoveturat me motor elektrik në transportin e udhëtarëve me taksi të Bashkisë Korçë do të jenë me ngjyrë të bardhë.
3. Autoveturat të cilat aktualisht kanë ngjyrën sipas vendimit të Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 46, datë 30.05.2001, “Për caktimin e ngjyrës të automjeteve të shërbimit taksi”, do të vazhdojnë të jenë me këtë ngjyrë ose kombimin ngjyrash deri në kohën kur subjekti do të kryejë ndryshimin (rinovimin) e automjetit të shërbimit taksi.
4. Vendimi i Këshillit të Bashkisë Korçë nr. 46, datë 30.05.2001, “Për caktimin e ngjyrës të automjeteve të shërbimit taksi”, shfuqizohet.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Ana Verushi

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva Naçi

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1

Zbardhur më datë 26-03-2026

